



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr.33/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit F. H sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.1575/16 të dt.05.1.2017, për shkak të veprës penale: sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 par 1 të KPRK-së,pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit F. H dhe të prokurorit të shtetit Lumturije Hoxha me dt.25.1.2018 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri F. H i lindur me dt.09.7.1985 në fsh. P. rruga R.H nr. 9 ku edhe tani jeton, i biri F dhe nënës A e gjinisë M, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës , më parë i pa dënuar, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me dt.23.6.2016 rreth orës 19:00 , në rrugën R. H nr. 9 , në Pejë sulmon personin zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dhe atë policin Xh. Sh, B. L dhe B. B, në atë mënyrë që , pasi policët i përgjigjen ankesës së A. H , në lidhje me rastin kundër të pandehurit F i cili kishte thyer një xhamë të shtëpisë dhe kishte demoluar dhomat dhe lënduar dorën e tij, ku policët e urdhërojnë që i njëjti të dërgohet në spital mirëpo ky refuzon dhe fillon ti ofendoj dhe më pas edhe ti sulmoj duke tentuar që ti godas me grusht.

-me çka ka kryer veprë penale: sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 par 1 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurit konform nenit 41, 42, 49, 50,51,52, dhe nenit 410 par 1 të KPRK-së. I SHQIPTON.

DËNIM TË KUSHTËZUAR

Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 4 muaj , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 (një) vit nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale .

I pandehuri për shkak të gjendjes së varfër ekonomike lirohet nga pagimi i paushallit gjyqësor.

Të dëmtuarit për realizimin eventual të kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Shpenzime procedurale nuk ka pasur .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.05.1.2017 kundër të pandehurit F. H , ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.1575/16 për vepër penale : sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 par 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimi përkatësisht të mos pranimi të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit , mbrojtësit të tij , i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e sinqertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme , faktin se i pandehuri ka probleme shëndetësore , dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPRK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform neni 453 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform neni 463 të KPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform neni 365 të KPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë. 25.1.2018.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .